



# **BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS**

Nëntor 2022

# BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Nëntor 2022

## AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

**(Në këtë edicion të këtij buletini pasqyrohen aktivitetet për muajin nëntor të vitit 2022)**

### Komisioni Mbikëqyrës: Luftimi i korrupsionit dhe i krimeve ekonomike, prioritet madhor dhe interes nacional i vendit

Anëtarët e Komisionit Mbikëqyrës për Lëndët e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike vizituan Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, ku janë pritur nga Kryeprokurori i kësaj prokurorie.



Në takim, u tha se trajtimi i lëndëve të korrupsionit dhe i krimeve ekonomike është duke u bërë me përkushtim të vazhdueshëm nga të gjitha prokuroritë e vendit dhe konkretisht kjo po bëhet edhe nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë.

Gjithashtu, gjatë diskutimeve të anëtarëve të Komisionit me Kryeprokurorin, u theksua nevoja e angazhimit maksimal për trajtimin e këtyre lëndëve, pa marrë parasysh sfidat që dalin përpara kësaj prokurorie, sepse luftimi i korrupsionit është prioritet madhor dhe interes nacional i vendit.

### Komisioni për Çështje Normative: Zbatimi i akteve nënligjore në sistemin prokurorial do të monitorohet në vazhdimësi

Në kuadër të monitorimit të zbatimit të akteve nënligjore dhe me qëllim të përmbushjes së detyrave të punës, anëtarët e Komisionit për Çështje Normative,

vizituan Prokurorinë e Apelit dhe Prokurorinë Themelore në Prishtinë, ku janë pritur nga kryeprokurorët e këtyre prokurorive.



Në fokus të diskutimeve të sotme ishin aspektet e informimit për zbatimin e akteve nënligjore në fuqi dhe akteve që janë në proces të hartimit, diskutimit dhe miratimit në KPK, lehtësimin e qasjes në to, sfidat dhe vështirësitë në zbatimin e tyre dhe propozimet eventuale për plotësimin dhe ndryshimin e akteve normative.

Gjithashtu, u potencua se, zbatimi i akteve nënligjore në sistemin prokurorial do të monitorohet në vazhdimësi, me ç'rast është prezantuar pyetësi i hartuar për mbikëqyrjen e zbatimit të akteve nënligjore, i cili do të lehtësojë procesin e punës së Komisionit dhe do të ndihmojë në përmbushjen e detyrave që ndërlidhen me mbikëqyrjen e zbatimit të akteve nënligjore dhe hartimin e akteve të parapara me Strategjinë e KPK-së për vitin 2022-2024.

### Zëvendëskryesuesi Shabani, pjesë e takimit koordinues me partnerët zhvillimorë

Zëvendëskryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, i shoqëruar nga U.D. Drejtori i Sekretariatit të KPK-së, mori pjesë në takim koordinues me partnerët zhvillimorë për zbatimin e Strategjisë për Sundimin e Ligjit, ku përveç përfaqësuesve vendorë, morën pjesë edhe partnerët ndërkombëtarë dhe donatorët e sistemit të drejtësisë, takim ky, i cili u mbajt në Ministrinë e Drejtësisë.

Gjatë takimit u prezantuan aktivitetet institucionale për mbështetje nga partnerët zhvillimorë, të cilat dalin nga Strategjia për Sundimin e Ligjit.



Me këtë rast, Zëvendëskryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Veton Shabani, falënderoi partnerët zhvillimorë, duke thënë se ky takim koordinues ka për qëllim që të krijojë mundësinë e diskutimeve të përbashkëta lidhur me proceset nëpër të cilat po kalon sistemi i drejtësisë, prioritetet e punës dhe objektivat strategjike, nevojat për mbështetje dhe koordinimin e aktiviteteve, të cilat pashmangshëm do të mundësojnë avancimin e proceseve kryesore edhe në sistemin prokurorial.

### Prokuroria Themelore e Gjilanit me statistika të mira në trajtimin e lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike

Komisioni Mbikëqyrës për Lëndët e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike, ka vazhduar vizitat nëpër prokurori, ku sot kanë vizituar Prokurorinë Themelore të Gjilanit, me ç'rast janë pritur nga Kryeprokurori i kësaj prokurorie.



Gjatë këtij takimi është diskutuar lidhur me lëndët e korrupsionit dhe krimeve ekonomike, trajtimin e tyre dhe sfidat e ndryshme, që dalin në rrugën që ka përpara kjo prokurori.

Anëtarët e Komisionit, thanë se, sipas statistikave, në gjashtëmujorin e parë të këtij viti, Prokuroria Themelore e Gjilanit ka dalë prokuroria më e suksesshme në trajtimin e lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike. Por, përkundër rezultateve të mira, u kërkua përkushtim i vazhdueshëm në trajtimin e këtyre lëndëve.

### Mbahet takimi i tetë i Komitetit Drejtues të Projektit EUKOJUST

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës kryesoi takimin e tetë të Komitetit Drejtues të Projektit EUKOJUST.



Kryesuesi Maloku falënderoi përfaqësuesit e projektit dhe të gjithë akterët e përfshirë në realizimin e aktiviteteve të deritashme, duke theksuar aktivitetet kryesore që janë zhvilluar në kuadër të këtij projekti në mbështetje të sistemit prokurorial gjatë periudhës korrik-shtator 2022.

Takimi vazhdoi më miratimin e Raportit të gjashtë tremujor për realizimin e aktiviteteve të projektit, ndërsa janë prezantuar raporti i shtatë tremujor për periudhën korrik-shtator 2022 dhe Plani i punës së projektit për tremujorin e fundit të vitit 2022.

### Ofrojnë dorëheqje 10 prokurorë të komunitetit serb të Prokurorisë Themelore të Mitrovicës

Këshilli Prokurorial i Kosovës është njoftuar me ofrimin e dorëheqjes së 10 prokurorëve të komunitetit serb të Prokurorisë Themelore të Mitrovicës.



Po ashtu, dorëheqje kanë ofruar edhe stafi administrativ nga komuniteti serb i kësaj prokurorie.

### Vazhdojnë vizitat e Komisionit Mbikëqyrës për Korrupsion dhe Krime Ekonomike në prokuroritë e vendit

Komisioni Mbikëqyrës për Lëndët e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike vizitoi Prokurorinë Themelore të Pejës dhe Prokurorinë Themelore të Gjakovës, ku u pritën nga kryeprokurorët e këtyre prokurorive.



Rrjedhimisht në këtë takim u diskutua për lëndët e korrupsionit dhe të krimeve ekonomike, si dhe sfidat përkatëse që ndërlidhen në këtë aspekt me prokuroritë themelore në Pejë dhe në Gjakovë.

Anëtarët e Komisionit, theksuan se këto prokurori kanë vazhduar të trajtojnë lëndët e korrupsionit dhe krimeve ekonomike dhe natyrisht që edhe në të ardhmen kërkohet përkushtim i vazhdueshëm për trajtimin e këtyre lëndëve specifike.

### KPK-ja diskuton për gjendjen e krijuar në Prokurorinë Themelore të Mitrovicës

Këshilli Prokurorial i Kosovës mbajti një takim të jashtëzakonshëm, në të cilin kanë marrë pjesë edhe Kryeprokurori i Prokurorisë së Apelit, ai i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Kryeprokurori i



Prokurorisë Themelore të Mitrovicës dhe partnerët ndërkombëtarë.



Ky takim filloi me diskutimet lidhur me situatën e krijuar në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, pas ofrimit të dorëheqjes nga prokurorët dhe stafi administrativ i komunitetit serb. Me këtë rast, anëtarët e Këshillit kanë kërkuar nga Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Mitrovicës dhe Sekretariati i Këshillit Prokurorial që ta vlerësojnë gjendjen e krijuar dhe si njësi kompetente në kuadër të sistemit prokurorial të marrin masat e nevojshme dhe të paraqesin në Këshill propozimet konkrete për mirëfunksionimin e punës në Prokurorinë Themelore të Mitrovicës.

Gjatë takimit, Këshilli Prokurorial nuk u lëshua në shqyrtimin e dorëheqjeve të ofruara nga prokurorët dhe stafi administrativ, ngase paraprakisht nevojitet një analizë dhe vlerësim i gjendjes së krijuar nga organet kompetente lidhur me përgjegjësit eventuale që kanë shkaktuar këtë gjendje.

Në fund të diskutimit për gjendjen e krijuar në Prokurorinë Themelore të Mitrovicës, anëtarët e Këshillit, thanë se mbetën të përkushtuar për koordinimin e veprimeve me institucionet e tjera, me qëllim të mbarëvajtjes së punëve pa ndërprerje në këtë prokurori, por edhe të funksionimit të një ambienti të sigurt juridik në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Nga organet kompetente të Kosovës u kërkua të ofrojnë siguri për punonjësit dhe objektin e Prokurorisë Themelore në Mitrovicën Veriore.

Gjatë këtij takimi, po ashtu, Këshilli ka konfirmuar listën e kandidatëve për anëtarë të Këshillit Prokurorial të Kosovës nga radhët e prokurorëve të Prokurorisë së Apelit dhe ka themeluar Komisionin për Rishqyrtim për pozitën e shpallur për Drejtor të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Drejtor të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë.

## Mbahet punëtori dyditore për ngritjen e efikasitetit në implementim të SMIL-it

Komisioni për Administrimin e Prokurorive, në bashkëpunim dhe me mbështetje financiare nga Projekti EUKOJUST, është duke mbajtur një punëtori dyditore lidhur me gjetjet e raporteve të monitorimit të zbatimit të Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL).



Në hapjes e kësaj punëtorie, Kryesuesi i Komisioni për Administrimin e Prokurorive, tha se Këshilli Prokurorial i Kosovës është i përkushtuar në vazhdimësi për të punuar përmes trupave të vet për krijimin e kushteve sa më të mira të punës për të gjithë prokurorët dhe stafin në sistemin prokurorial.

Me tutje, ai, tha se nevoja e kësaj punëtorie ka dalë në pah si rezultat i monitorimit të implementimit të SMIL-it nëpër prokurori, ku edhe janë evidentuar disa mangësi, andaj besoj që gjatë kësaj punëtorie do të arrijmë t'i përmirësojmë ato mangësi dhe të kemi funksionim sa më të mirë të SMIL-it.

Në këtë punëtori, përveç Komisionit për Administrimin e Prokurorive dhe përfaqësuesve të projektit EUKOJUST, morën pjesë edhe përfaqësues të Zyrës së BE-së në Kosovë, Këshillit të Evropës, kryeprokurorë, prokurorë dhe akterë të tjerë, puna e të cilëve ndërlidhet me implementimin e SMIL-it.

## Prokurori Arian Gashi votohet për anëtar të KPK-së

Në Prokurorinë e Apelit të Republikës së Kosovës sot është realizuar procesi për votimin e anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) nga radhët e kësaj prokurorie.

Në bazë të kompetencave ligjore, nga të gjithë prokurorët e kësaj prokurorie që kishin të drejtë të kandidohen për anëtarë të KPK-së, këtë të drejtë e kanë shfrytëzuar prokurori Agron Bajrami dhe prokurori Arian Gashi.




Në procesin zgjedhor kanë marrë pjesë shtatë prokurorë, aq sa ka gjithsej kjo prokurori, ndërsa pas procesit të votimit dhe numërimit të votave, me 4 vota për, për pozitën e anëtarit të KPK-së nga radhët e Prokurorisë së Apelit është votuar prokurori Arian Gashi, ndërsa për prokurorin Agron Bajrami kanë qenë tri vota.

Procesi zgjedhor në Prokurorinë e Apelit është zhvilluar duke u mbështetur në afatet ligjore, ngase anëtares së KPK-së nga kjo prokurori, prokurores Bedrije Sylaj-Alshiqi, i përfundon mandati në fund të këtij viti. Po ashtu, ky proces është monitoruar nga organizatat e shoqërisë civile, Grupi për Studime Juridike dhe Politike dhe Betimi për Drejtësi.

### Anëtarët e Komisionit për Çështje Normative vizitojnë Prokurorinë Themelore në Prizren

Anëtarët e Komisionit për Çështje Normative zhvilloi vizitën e radhës në Prokurorinë Themelore në Prizren, ku u pritën në takim nga Kryeprokurori e kësaj prokurorie.



Ky takim është realizuar në kuadër të monitorimit të zbatimit të akteve nënligjore dhe me qëllim të përmbushjes së detyrave të punës, me ç'rast u diskutuan detajet dhe aspektet informuese për zbatimin e akteve nënligjore në fuqi dhe akteve në proces hartimi, diskutimi dhe miratimi në KPK.

Anëtarët e Komisionit diskutuan edhe për lehtësimin e qasjes në këto akte, vështirësitë e mundshme gjatë zbatimit të tyre dhe propozimet eventuale për plotësimndryshimin e tyre dhe prezantuan pyetësorin e hartuar për mbikëqyrjen e zbatimit të akteve nënligjore, i cili do të lehtësojë procesin e punës së Komisionit dhe përmbushjen e detyrave për mbikëqyrjen e zbatimit të akteve nënligjore dhe hartimin e akteve të parapara me Strategjinë e KPK-së për vitin 2022-2024.

### Mbahet takimi i Komisionit për Çështje Normative

Komisioni për Çështje Normative mbajti shqyrtoi dispozitat e draftit të Rregullores për Rekrutimin dhe Përzgjedhjen e Bashkëpunëtorëve Profesionalë, i cili parasheh mënyrën, kriteret dhe procedurën e rekrutimit të bashkëpunëtorëve profesionalë në sistemin prokurorial.



Me këtë rast, anëtarët e Komisionit, potencuan se përmes këtij drafti të rregullores do të realizohet një procedurë me efikase dhe më profesionale për rekrutimin e bashkëpunëtorëve profesionalë.

### Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Dogana e Kosovës me memorandum bashkëpunimi

Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Dogana e Kosovës nënshkruan një memorandum të bashkëpunimit, i cili është nënshkruar nga Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Drejtori i Doganës së Kosovës.

Qëllimi i këtij memorandum është ndërlihdja e sistemeve elektronike dhe shkëmbimi i të dhënave në formë elektronike në mes të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Doganës së Kosovës.



Të gjitha të dhënat nga Dogana e Kosovës në prokurori do të dërgohen në formë elektronike nga sistemet e tyre për menaxhimin e lëndëve dhe anasjelltas.

Pas nënshkrimit të këtij memorandumi, Kryesuesi i KPK-së dhe Drejtori i Doganës së Kosovës, vlerësuan lart bashkëpunimin e deritashëm të dy institucioneve përkatëse, duke thënë se ky memorandum i nënshkruar vërteton gatishmërinë e përbashkët për thellimin e bashkëpunimit, me qëllimin e vetëm - fuqizimin e luftës kundër dukurive kundërligjore.

### KPK e vlerëson si veprim kundërkushtetues dhe kundërligjor vendimin e sotëm të Qeverisë

Këshilli Prokurorial i Kosovës mbajti takim të jashtëzakonshëm, në të cilin diskutoi vetëm një pikë e rendit të ditës - lidhur me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për përgjysmimin e pagave të prokurorëve. Në këtë takim kanë marrë pjesë edhe kryeprokurorët e prokurorive.



Në fillim të këtij takimi, anëtarët e KPK-së dhe kryeprokurorët e prokurorive të Republikës së Kosovës një zëri kanë vlerësuar se vendimi i sotëm i Qeverisë së Republikës së Kosovës është vendim kundërkushtetues dhe kundërligjor, si dhe ndërhyrje flagrante në pavarësinë e sistemit prokurorial.

Në këtë takim Këshilli Prokurorial i Kosovës ka nxjerrë vendim ku kërkon nga Qeveria e së Republikës së Kosovës që menjëherë të anulojë vendimin Nr. 03/109 të datës 23 nëntor 2022.

Në ndërkohë, puna e prokurorive do të reduktohet dhe do të vazhdojë vetëm me shërbime esenciale, po ashtu Këshilli dhe prokuroritë do të pezullojnë të gjitha format e bashkëpunimit me përfaqësuesit e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Nëse ky vendim nuk shfuqizohet deri me datë 08 dhjetor 2022, Këshilli do të do të vendosë për masa tjera më radikale.

### Aktivitetet e Sekretariatit të KPK-së

Sekretariati i KPK-së, gjatë muajit nëntor, ka mbajtur takimin e udhëheqësve institucional për Raportin e misionit kolegjial, i bazuar në rastet për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe ka mbajtur takime me grupin punues për realizimin e projektit për hapjen e dritareve në Pallatin e Drejtësisë.

Gjatë nëntorit është përgatitur edhe teksti dhe skenari për videon informuese për takimet e qytetareve nëpër të gjitha prokuroritë themelore të vendit dhe është përgatitur Plani i aktiviteteve të Projektit TIK/SMIL për vitin 2023, i cili ka për qëllim zbatimin e SMIL-it në të gjitha prokuroritë dhe ngritjen e cilësisë së të dhënave të regjistruar.

Sa i përket forcimit të kapaciteteve profesionale ka ofruar mbështetje për organizimin dhe mbajtjen e punëtorisë me administratën e prokurorive për zbatimin e SMIL-it, pastaj ka mbajtur punëtorinë me temën “Prezantimi i raporteve për monitorimin e zbatimit të SMIL-it”, e cila është organizuar në bashkëpunim me Projektin EUKOJUST. Gjithathtu, anëtarët e stafit administrativ morën pjesë në punëtorinë: “Identifikimi i nevojave dhe hartimin e kurikules trajnuese” dhe në trajnimet e organizuara nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike me temat: “Sistemi evropian i mbrojtjes së të drejtave të njeriut” dhe “ Sjellje organizative”, si dhe është organizuar punëtorija “Identifikimi i nevojave për hartimin e kurikules trajnuese për Komisionin për Vlerësimin e Performancës”.

Nga ana tjetër është mbajtur një takim me përfaqësuesit e Ambasadës Amerikane, ku është diskutuar përgatitja e specifikacionit teknik për hapjen e faqeve në rrjetet sociale dhe krijimin i një kanalit në youtube, si dhe ka përfunduar verifikimi në aspektin e kualitetit të të dhënave për të gjitha lëndët e përzgjedhura dhe është publikuar versioni i ri i SMIL-it,



i cili përmban mundësinë e editimit të të dhënave nga përdoruesit, bartjen e të dhënave etj.

Është prezantuar edhe publikimi i Raportit të Monitorimit të Drejtësisë i EULEX-it dhe është publikuar për konsultim publik drafti i Rregullores për procedurën e rekrutimit dhe përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve profesionalë, si dhe njoftimi përkatës.

Po ashtu është finalizuar Raporti analitik nëntëvjeçar (2013-2021) dhe i njëjti është proceduar fillimisht për përkthim dhe për shqyrtim dhe miratim (së bashku me rekomandime), në KPK.

## Aktivitetet e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë

NJSHP-ja, gjatë muajit nëntor 2022, ka përfunduar hartimin e raportit nëntëmuor të punës së Prokurorit të Shtetit, ka përgatitur komente dhe forma plotësuese të raportit statistikor të SMIL-it, si dhe ka dhënë kontribut në punëtoritë të organizuara, me qëllim të rritjes së efikasitetit të punës për raportimin statistikor përmes SMIL-it. Nga ana tjetër kontribuoi edhe në takime me kompaninë për zhvillimin e raporteve statistikore të SMIL-it, zhvillimin dhe plotësimin e matricës së përmbledhur me shënime statistikore me të dhënat për vitin 2022 lidhur me mënyrën e zgjidhjes së rasteve nga ana e prokurorive dhe hartimin e përshkrimit të detyrave të punës për stafin e ZMAVP-së, sipas Draftrregullores për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Administratës në Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Gjithashtu u përgatitën raportet statistikore për gjendjen numerike të rasteve për muajin tetor për prokuroritë themelore, Prokurorinë Speciale të Apelit sipas regjistrave dhe janë janë përgatitur raportet për ngarkesën e prokurorëve me lëndë dhe efikasitetin në zgjidhjen e tyre, gjatë muajin tetor për secilin prokuror veç e veç për të gjitha prokuroritë, përveç ZKPSH-së.

Ndërkohë janë gjeneruar të dhënat nga aplikacioni kriMKorr, me ç'rast janë përgatitur edhe raportet statistikore për gjendjen numerike të rasteve sipas grupeve të veprave penale nga Mekanizmi përcjellës për muajin tetor, si dhe janë janë përgatitur të dhënat për DASH-in për muajin tetor, pastaj ASK-së iu kanë dërguar të dhënat statistikore sipas formave të veçanta sipas kërkesës së EUROSTAT-it.